

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e Forumit për Iniciativa Qytetare

Ne kemi kryer auditimin e pasqyrave financiare dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit si dhe shënimeve tjera shpjeguese të Forumit për Iniciativa Qytetare ("FIQ") për vitin që ka përfunduar me datën 31 dhjetor 2013. Pasqyrat financiare për vitin që përfundoj me datën 31 dhjetor 2012 janë audituar nga një auditor tjetër, raporti i tyre është i datës 31 mars 2013 dhe ata kanë shprehur një mendim të pakualifikuar në lidhje me ato pasqyra financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti i FIQ-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në pajtim me politikat e pranuar të kontabilitetit siç është përcaktuar në shënimin 2 të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: projektimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrës financiare e cila nuk ka deklarime të gabueshme, qoftë kjo për arsye të gabimit apo mashtrimit; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme të kontabilitetit; dhe kryerjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme në ato rrethana.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrën financiare të bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ato standarde kërkojnë që ne të kemi përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin që të arrijmë deri të sigurime të arsyeshme në lidhje me atë se a është pasqyra financiare pa gabime materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave që të fitohen dëshmi të auditimit në lidhje me shumat dhe shpalosjet në pasqyra financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të pasqyrës financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Me kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori i merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për prezantimin e drejtë dhe përgatitjen e pasqyrës financiare në mënyrë që të projektoj procedura të auditimit të cilat i përshtaten kushteve, por jo për qëllime të shprehjes së mendimit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të asaj njësie ekonomike. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit të bëra nga menaxhmenti, si dhe për vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrës financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit të cilat ne i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të sigurojnë bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, janë një pamje të drejtë dhe të vërtetë e pozitës financiare deri me datën 31 dhjetor 2013 dhe performancës së veprimtarive për vitin që ka përfunduar me datën 31 dhjetor 2013 në pajtim me politikat e pranura të kontabilitetit siç është përcaktuar në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

BDO Kosova Sh.P.K.

Prishtina, Kosova

27 janar 2014

Raportin më të detajuar e gjeni në gjuhën angleze [KETU](#).